



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

DOSJA E TENDERIT

“SHERBIME”

PROCEDURA E HAPUR

Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit:

21/12/2020

Nr ¹ i prokurimit	AKP-AL	0	0	1
------------------------------	--------	---	---	---

Titulli: Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP

KJO DOSJE E TENDERIT PERBEHET PREJ TRI PJESËVE:

- Pjesa A:** Procedurat e tenderimit që përmbajnë udhëzime për përgatitjen e tenderit;
- Pjesa B:** Draft Kontrata që përmban kushtet kontraktuese të cilat duhet t'i pranojë tenderuesi që merr kontratën; dhe
- Pjesa C:** Formulari i Tenderit, d.m.th. dokumentet që duhet t'i paraqesin tenderuesit

Kjo dosje e tenderit është përgatitur në gjuhën Shqipe.

Ne rast të kërkesës dosja e tenderit do të jete e disponueshme edhe në gjuhën Serbe*

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

TEMA: FTESË PËR TENDER për: Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP

Ju faleminderit për interesimin e juaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartë përmendur të prokurimit.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë Dosjen e Tenderit.

Nga ju pritet që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët, nenet dhe anekset e kësaj dosjeje të tenderit dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Ne, si Autoritet Kontraktues nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Në rast të dështimit të dorëzimit të tenderin tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen e Tenderit, dhe/apo nuk është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, do të refuzohet dhe do të konsiderohet si “*tender i papërgjegjshëm*”

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin e tenderit duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura.

Operatorët ekonomik të cilit dëshirojnë të dorëzojnë tenderin, si dhe autoriteti kontraktues, duhet të respektojnë kërkesat që rrjedhin nga Ligji i Prokurimit Publik (LPP) dhe Rregullat e Prokurimit të nxjerra në përputhshmëri me të.

Tenderi duhet të dorëzohet në adresën e specifikuar në pjesën A “Procedurat e Tenderimit” para datës 05.01.2021, koha: ora 14:00h.

Me dorëzimin e tenderit, tenderuesi pranon në mënyrë të plotë dhe pa kufizime, kushtet e veçanta dhe të përgjithshme që rregullojnë këtë kontratë si një bazë të vetme të kësaj procedure të tenderimit, pavarësisht nga kushtet e tij ose të saj të shitjes, nga të cilat ai/ajo me këtë rast heq dorë

Me sinqeritet,

Emri dhe Mbiemri: Bajram Sherifi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit; dhe
Albert Matoshi, Kryesues i Autoritetit të Likuidimit

Nënshkrimi: _____

PËRMBAJTJA E TABELËS

<i>PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT</i>	4
SEKSIONI I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT	4
TË PËRGJITHSHME	4
KËRKESAT QË DUHET TË PLOTËSOHEN NGA OPERATORËT EKONOMIK	4
PËRMBAJTJA E DOSJES SË TENDERIT	7
PËRGATITJA E TENDERIT	8
DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE	9
VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE	10
DHËNIA E KONTRATËS	10
SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD).....	12
ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME	16
KËRKESAT PËR GRUMBULLIMIN DHE INTEGRIMIN E TË DHËNAVE.....	16
KËRKESAT PËR TRAJNIMIN E PËRDORUESVE	17
KËRKESAT PËR MIRËMBAJTËN	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
KËRKESAT TJERA.....	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
ANEKSI 2 DEKLARATA NËN BETIM	22
ANEKSI 4 SIGURIA E TENDERIT.....	23
ANEKSI 5 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË	24
<i>PJESA B: DRAFT KONTRATA & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA</i>	25
<i>PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA</i>	25
<i>PJESA II E KONTRATËS KUSHTET E PËRGJITHSHME</i>	27
<i>PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA</i>	34
<i>PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT</i>	35
<i>PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR</i>	36
<i>PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT</i>	37
<i>PJESA I. FORMULARI I TENDERIT</i>	37

PJESA A: PROCEDURAT E TENDERIMIT

SEKSIONI I. INFORMACIONE PËR TENDERUESIT

TË PËRGJITHSHME

- 1. Fusha e tenderit**
- 1.1 Autoriteti Kontraktues i **cekur në Fletën e të Dhënave të Tenderit (FDT)**, lëshon e këtë Dosje të Tenderit për shërbime siç specifikohet në Specifikimet teknike, Aneksi 1, dhe në Pjesën C, Përshkrimi i Çmimeve.
- 1.2 Titulli i kontratës dhe numri identifikues i këtij aktiviteti të prokurimit janë të **shënuara në FDT**.
- 1.3 Informacioni mbi publikimin e Njoftimit të Kontratës është e **shënuar në FDT**.
- 1.4 Tenderët duhet të dorëzohen në adresën e autoritetit kontraktues të **shënuar në FDT**.
- 1.5 Përgjatë kësaj Dosje të Tenderit:
- a) shprehja “me shkrim” kuptohet komunikimi në formë të shkruar (p.sh. me e- mail, faks, teleks) me dëshmi të pranimit;
- b) nëse konteksti kërkon “njëjës” gjithashtu nënkupton “shumës” dhe anasjelltas;
- c) “ditë” nënkupton ditën kalendarike;
- d) ju jeni të referuar si “operator ekonomik” apo “tenderues” dhe
- e) lëshuesi i kësaj dosje të tenderit referohet si “autoritet kontraktues”.
- 2. Qëllimi i Kontratës**
- 2.1 Klasifikimi i Përgjithshëm i Fjalorit të Prokurimit dhe qëllimi i kontratës **janë të shënuara në FDT**.
- 3. Specifikimet teknike të detyrueshme**
- 3.1 Shërbimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, shih Aneksin 1, dhe në përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasisë, modelet mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera. Kjo do të demonstron me dorëzimin e provave të dokumentuara të **përcaktuara në FDT**.
- 3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin.
- 4. Variantet**
- 4.1 **Përveç nëse është e shënuar ndryshe në FDT**, tenderuesit nuk janë të autorizuar të dorëzojnë tender që propozon ndonjë variant i cili është në pajtueshmëri me një variant të specifikimeve teknike.
- 5. Kushtet dhe kërkesat e dërgesës**
- 5.1 Vendi i performimit të shërbimeve **është e shënuar në FDT**.
- 5.2 Afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës **siç është shënuar në FDT**.

KËRKESAT që duhet të plotësohen nga OPERATORËT EKONOMIK

Operatorët ekonomik duhet t'i plotësojnë të gjitha kërkesat në vijim. Çdo mos përmbushje e ndonjëres nga kërkesat do të eliminojë tenderin e tyre nga konkurrimi.

Kërkesat e përshtatshmërisë

6. Përshtatshmëria e operatorëve ekonomik

6.1 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ose ndonjë drejtues, menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të fundit:

a. është shpallur fajtorë nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale ose civile duke përfshirë praktikat e korrupsionit, larjen e parave, mitosjen, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme me ato të përshkruara në nenin 129.1 të këtij ligji sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Kosovë ose në cilindo shtet, ose në çfarëdo marrëveshje ose konvente ndërkombëtare;

6.2 Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse ai operator ekonomik:

a. gjatë dy (2) viteve të kaluara është shpallur nga një gjykatë kompetente si i falimentuar ose insolvent, ose aktualisht është në procedurë: (i) të falimentimit, (ii) të pranimit të urdhrit për likuidim ose përmbyllje të aktiviteteve ose administrimit nga gjykata ose (iii) ndonjë procedurë tjetër të ngjashme sipas ligjit të Kosovës ose ndonjë juridiksioni tjetër:
të shërbimeve publike në Kosovë;

Periudhat kohore të përcaktuara në këtë nen, ndërlidhen me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës.

6.4 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik ka të drejtë pjesëmarrjeje në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet të dorëzojë dëshmitë e dokumentuara **të shënuara në FDT.**

Kërkesat minimale kualifikuese

7. Kërkesat mbi përshtatshmërinë profesionale

7.1 Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat e përshtatshmërisë profesionale **të shënuara në FDT.**

7.2 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik është i përshtatshëm të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese **të shënuara në FDT.**

8. Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

8.1 Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale ekonomike financiare **të shënuara në FDT.**

8.2 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale ekonomike financiare operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese **të shënuara në FDT.**

9. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

9.1 Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/apo profesionale **të shënuara në FDT.**

9.2 Në mënyrë që të dëshmohet se operatori ekonomik i plotëson kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/apo profesionale, operatori ekonomik duhet t'i dorëzojë dokumente dëshmuese **të shënuara në FDT.**

10. Krijimi i një grupi te operatoreve ekonomik

10.1 Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, grupi është i detyruar të **emëroj njërin nga anëtarët** e grupit si operator ekonomik kontaktues dhe duhet të prezantoj me tenderin e tij dokumentet **e shënuar në FDT.**

10.2 Nga një grup i tillë nuk do të kërkohej për të marrë përsipër ndonjë formë të veçantë ligjore për të paraqitur tenderin, por Autoriteti kontraktues rezervon të drejtën, nëse një kërkesë e tillë është e nevojshme për përmbushjen e mjaftueshme të kontratës, të kërkoj nga grupi i përzgjedhur për ta bërë këtë nëse kontrata i jepet një grup të tillë si parakusht për nënshkrimin e kontratës.

11. Nën-kontraktimet

11.1 Operatorët Ekonomikë në tenderin e tyre duhet të deklarojnë cilëndo pjese të kontratës që Operatori Ekonomik ka për qëllim të nënkontrakttojë palën e tretë dhe të dorëzojë me tenderin e tij dokumentet e **shënuara në FDT**.

12. Sigurimi i tenderit

12.1 **Në qoftë se shënohet në FDT** tenderuesi duhet të dorëzojë, si pjesë të tenderit të tij, një Sigurim të tenderit.

12.2 Siguria e tenderit duhet të jetë në shumën dhe për një periudhë valide siç është **e shënuar në FDT**, dhe mund të dorëzohet në një nga format e shënuara si më poshtë:

- a) transferte bankare në ç'rast siguria e tenderit duhet të depozitohet në Bankën siç është **e shënuar në FDT**;

12.3 Nëse kërkohej Sigurimi i Tenderit dhe ndonjë tender nuk është shoqëruar me një Sigurim të konsiderueshme të përgjegjshëm të Tenderit, tenderi do të refuzohet si tender i papërgjegjshëm.

12.4 Forma e sigurisë së tenderit është e specifikuar në Aneksin 4 të kësaj dosje të tenderit.

12.5 Autoriteti kontraktues do ta kthejë sigurinë e tenderit të depozituar brenda pesë (5) ditëve, pas ndodhjes së cilës do nga ngjarjet në vijim:

- a) skadimi i datës së vlefshmërisë së tenderit;
- b) dhënia dhe hyrja në fuqi e kontratës;
- c) anulimi ose përfundimi i aktivitetit të prokurimit para dhënies ose hyrjes në fuqi të kontratës;
- d) Me tërheqjen e tenderit para afatit të fundit për dorëzimin e tenderit, përveç nëse është e deklaruar në DT që nuk është e lejuar një tërheqje e tillë.

12.6 Sigurimi i Tenderit mund të konfiskohet nëse:

1. Autoriteti Kontraktues cakton që operatori Ekonomik ka dorëzuar informata të rrejshme apo mashtruese;

2. Operatori Ekonomik e tërheq tenderin e tij pas datës së fundit për dorëzimin e tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit dhe

3. Operatorit Ekonomik i është dhënë kontrata por refuzon ose dështon:

- a) që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit;
- b) të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës; ose
- c) që të zbatojë kontratën.

13. Siguria e Ekzekutimit

13.1 **Në qoftë se është cekur në FDT**, para nënshkrimit të Kontratës, tenderuesi i suksesshëm, do t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues një Sigurim të Ekzekutimit.

13.2 Sigurimi i ekzekutimit duhet të jetë në vlerën dhe për një periudhë valide **siç është shënuar në FDT**.

13.3 Forma e Sigurisë së Ekzekutimit është e specifikuar në Pjesën B, Seksioni IV.

13.4 Siguria e ekzekutimit mund të depozitohet në njërin nga format e cekura për Sigurimin e tenderit.

13.5 Dështimi i Operatorit të suksesshëm Ekonomik për të dorëzuar Sigurinë e Ekzekutimit të lart-përmendur ose nënshkrimit të Kontratës, do të përbëjnë arsye të mjaftueshme për anulimin e dhënies dhe konfiskimin e sigurisë së tenderit.

13.6 Sigurimit i Ekzekutimit do të konfiskohet në rast të:

a) shkeljes së kontratës së nënshkruar, e cila i shkakton dëme materiale autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime materiale për përfundimin e kontratës në fjalë, dhe

b) Kontrata e nënshkruar është prishur dhe shumë punëtorë kanë mbetur të papaguar, nënkontraktorët dhe / ose furnizuesit e materialeve;

13.7 Në rast se nuk ka ndodhur asnjë nga rrethanat e cekura më lart, që do të shkaktonin konfiskimin e sigurisë së ekzekutimit, autoriteti kontraktues do t'i kthejë fondet ose dokumentet që janë depozituar në formë të sigurisë së ekzekutimit, në pajtim me kushtet e kontratës.

PËRMBAJTJA E DOSJES SË TENDERIT

14. Seksionet e Dosjes se Tenderit

14.1 Dosja e Tenderit përbëhet nga Pjesa A, B, dhe C, të cilat përfshijnë të gjitha Seksionet e prezantuara më poshtë, dhe duhet të lexohen së bashku me ndonjë Shtojcë të lëshuar në përputhje me Informacion për Tenderuesit Neni 17.

PJESA A Procedurat e Tenderimit

- Seksioni I, Informata për Tenderuesit
- Seksioni II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT)
- Anekset

PJESA B Kontrata

- Seksioni I, Draft Kontrata
- Seksioni II, Kushtet e Përgjithshme të Kontratës(KPK)
- Seksioni III, Kushte e Veçanta të Kontratës (KVK)
- Seksioni IV, Formulari i Garancionit të Përmbushjes
- Seksioni V, Identifikimi Financiar

PJESA C Forma e Tenderit

- Neni I, Forma e Tenderit
- Neni II. Përshkrimi i Çmimeve

15. Sqarimet e Dosjes se Tenderit

15.1 Tenderuesit janë të lejuar të bëjnë një kërkesë me shkrim pran autoritetit kontraktues për informata shtesë ose sqaruese që ata mendojnë se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi të përgjegjshëm. Autoriteti Kontraktues do të përgjigjet me shkrim çdo kërkesë për sqarim, me kusht që kërkesa e tillë është marrë jo më vonë se afati i **dhëne në FDT**. Autoriteti kontraktues do të dërgon kopjet e përgjigjes së tij tek të gjithë ata që kanë pranuar Dosjen e Tenderit duke përfshirë pyetjen por pa e identifikuar burimin e saj. Nëse Autoriteti kontraktues e sheh të domosdoshme që të ndryshoj Dosjen së Tenderit, si rezultat i sqarimit, atëherë duhet ta bëjë këtë sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 17 të Informatave për Tenderuesit.

16. Ndryshimi i Dosjes 16.1 Në çdo kohë para skadimit të afatit të fundit për dorëzimin e DOSJA E TENDERIT PËR KONTRATA PUBLIKE – HAPUR/Shërbime

se Tenderit tenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të ndryshojë Dosjen e Tenderit duke lëshuar një shtojcë.

16.2 Çdo shtojcë e lëshuar do të jetë pjesë e Dosjes së Tenderit dhe do t'i komunikohet me shkrim të gjithë operatorëve ekonomik që kanë marrë Dosjen e Tenderit.

16.3 Për t'iu dhënë tenderuesve të mundshëm kohe të mjaftueshme për të marrë parasysh shtesën në përgatitjen e ofertave të tyre, Autoriteti Kontraktues do të zgjasë afatin kohor për dorëzimin e tenderëve në përputhje me Nenin 53 të LPP-së.

PËRGATITJA E TENDERIT

17. Gjuha e Tenderit 17.1 Operatorët Ekonomik mund të përgatisin dhe të dorëzojnë tenderët e tyre dhe dokumentet e lidhura në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

18. Dokumentet që përbejnë Tenderin 18.1 Tenderi duhet të përmbajë si në vijim:

- a) Formën e Tenderit dhe Përshkrimin e Çmimeve duke përdorur format e dhëna në Pjesën C të kësaj Dosje të Tenderit;
- b) Sigurimin e Tenderi, në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 13, *nëse aplikohet*;
- c) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 6, evidentimi i përshtatshmërisë së Tenderuesit;
- d) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 7, evidentimi i të përshtatshmërisë profesionale, *nëse aplikohet*;
- e) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 8, evidentimi i gjendjes ekonomike dhe financiare, *nëse aplikohet*;
- f) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 9, evidentimi i mundësisë teknike dhe profesionale, *nëse aplikohet*;
- g) Dokumentet dëshmuese në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Neni 11 dhe 12, *nëse aplikohet*; dhe
- h) Ndonjë dokument tjetër që kërkohet në FDT.

19. Valuta dhe Kalkulimi i Çmimit 19.1 Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€)

19.2 Çmimet e tenderit për shërbimet e ofruara janë të fiksuara **për gjatë ekzekutimit të kontratës** dhe nuk mund të ndryshohen.

20. Periudha e Vlefshmërisë së Tenderit 20.1 Tenderët do të mbeten të vlefshme për aq kohë sa është e **shënuar në FDT**. Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të filloj në datën e afatit të fundit të dorëzimit të tenderëve.

20.2 Në rrethana të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga tenderuesit zgjatjen e periudhës së vlefshmërisë së tenderëve të tyre. Kërkesat dhe përgjigjet duhet të bëhen me shkrim. Nëse Sigurimi i Tenderit kërkohet ajo do të zgjatet edhe për një periudhë përkatëse. Dështimi për t'iu përgjigjur kërkesës së bërë nga autoriteti kontraktues do të çojë në refuzimin e tenderit, pa konfiskim të Sigurimit të Tenderit të tij.

21. Vulosja dhe Shënimi i Tenderit 21.1 Tenderuesi duhet të përgatisë një origjinal të dokumenteve që përbëjnë tenderin, siç përshkruhet në Informatat për Tenderuesit Neni 19 dhe në mënyrë të qartë të shënojë atë "**ORIGJINAL**." Përveç kësaj, Tenderuesi duhet të paraqesë kopje të tenderit, në numrin e **shënuar në FDT** dhe në mënyrë të qartë shënojë ato "**KOPJE**".

21.2 Tenderuesi duhet të vendose tenderin origjinal dhe çdo kopje **në zarfe të veçanta** dhe në anën e përparme të secilit zarf do të:

- Shënon qartë si "**Origjinal**" apo "**Kopje**";
- Shënon numrin e Prokurimit siç është e cekur në dosjen e tenderit;
- Shënon emrin dhe adresën e tenderuesit.

21.3 Zarfet pastaj duhet të mbyllen në një zarf të jashtëm që tregon vetëm:

- Adresën e vendit të dorëzimit të tenderëve;
- Numrin e Prokurimit;
- Paralajmërim, se zarfi nuk guxon të hapet para datës dhe kohës së hapjes së tenderit; dhe
- Emrin dhe adresa e tenderuesit

DORËZIMI DHE HAPJA E TENDERËVE

22. Afati i fundit për dorëzim te tenderëve

22.1 Tenderët do të pranohen nga Autoriteti Kontraktues jo më vonë se data dhe koha e **shënuar në FDT**.

23. Tenderët e vonuar

23.1 Autoriteti Kontraktues nuk do marrë në konsideratë ndonjë tender që arrin pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve. Cilido tender i pranuar nga Autoriteti Kontraktues pas afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve do të deklarohet i vonshëm dhe do t'i kthehet tenderuesit i pa hapur.

24. Tërheqja , Zëvendësimi, dhe Modifikimi i Tenderëve

24.1 Përveç nëse është cekur **ndryshe në FDT**, Tenderuesi mund të tërheq, Ndërron apo Modifikoj tenderin e tij, pasi që të jete dorëzuar duke dorëzuar një shkresë me shkrim tek Autoriteti Kontraktues, e cila shkresë duhet të jete e nënshkruar siç duhet nga përfaqësuesi autorizues. Zëvendësimin përkatës ose modifikim të tenderit duhet të shoqërohen me njoftimin përkatës me shkrim. Të gjitha njoftimet duhet të jenë:

- a. të dorëzuara në përputhje me Informatat për Tenderuesit, Seksioni 22 dhe përveç kësaj, zarfet përkatës, do të shënohet qartë "TËRHEQJE," "ZËVENDËSIMI," ose "MODIFIKIM"; dhe
- b. të pranohen nga Autoriteti Kontraktues para afatit të fundit të përcaktuara për dorëzimin e tenderëve.

24.2 Tenderët e kërkuara për tërheqje duhet të dorëzohen të pa hapura tek Tenderuesit.

24.3 Asnjë tender nuk mund të tërhiqet gjatë intervalit kohor prej afatit të fundit të dorëzimit të tenderit deri tek skadimi i periudhës së vlefshmërisë së tenderit. Tërheqja e tenderit gjatë këtij afati do të rezultojë me konfiskimin e sigurimit të tenderit.

25. Hapja e Tenderëve

25.1 Autoriteti Kontraktues do të bëjë hapjen e tenderit në publik në adresën, datën dhe kohën **e cekur në FDT**.

25.2 Çdo tenderues ka të drejtë të ketë përfaqësuesin prezent që të vrojtoj hapjen e tenderëve.

25.5 Të gjitha zarfet e tjera do të hapen në një kohë, duke lexuar me zë: emrin dhe adresën e tenderuesit dhe Çmimin total të tenderit të specifikuar në formularin e dorëzimit të Tenderit. E gjithë kjo duhet të regjistrohen në procesverbalin e hapjes së tenderëve, i cili duhet të nënshkruhet nga Zyrtari i Prokurimit dhe nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e hapjes së tenderit. Kopjet e procesverbalit në fjalë, duhet tu dërgohen menjëherë të gjithë tenderuesve.

VLERËSIMI DHE KRAHASIMI I TENDERËVE

26. Ekzaminimi i tenderëve

26.1 Tenderët e pranuar **me kohë** do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në bazë të procedurës së përcaktuar në Udhëzuesin nr. 1/2009 per Autoitetet e Likuidimit.

26.2 Tenderi konsiderohet të jetë i **përgjegjshëm** kur:

- a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të kësaj dosjeje të tenderit;
- b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në këtë dosje të tenderit;
- c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përgjedhjes të përcaktuara në këtë dosjeje të tenderit.

27. Sqarimi i Tenderëve

27.1 Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë nga secili Tenderues individualisht sqarim mbi tenderin e tij/saj. Secili sqarim që dorëzohet nga tenderuesi në lidhje me tenderin e tij dhe që nuk është në përputhje me kërkesën nga autoriteti kontraktues nuk do të konsiderohet.

27.2 Kërkesa për sqarim dhe përgjigjja duhet të bëhen vetëm me shkrim, por nuk guxon të kërkohet, ofrohet ose lejohet asnjë ndryshim në çmim ose në ndonjë kusht ose aspekt material të tenderit.

28. Përgjegjshmëria e tenderëve

28.1 Nëse tenderi nuk është i përgjegjshëm do të refuzohet dhe nuk mund të bëhet i tillë që të jetë në pajtueshmëri më vonë duke e korrigjuar atë ose duke e tërhequr largimin ose kufizimin.

28.2 Tenderët e **përgjegjshëm** do të vlerësohen dhe krahasohen sipas kriterëve për dhënien e kontratës të përcaktuara në Dosjen e tenderit. Tenderuesi i cili ka dorëzuar tenderin e renditur më të lartë do t'i jepet kontrata.

DHËNIA E KONTRATËS

29. Kriteret e Dhënies se Kontratës

29.1 Kontrata do të shpërblehet sipas kriterëve për dhënien e kontratës siç janë **shënuar në FDT**

30. Ankesat

30.1 Ankesa mund të paraqitet me shkrim tek Komisioni Shqyrtues i ankesave pranë **AKP-së, në këtë adresë rr.Agim Ramadani nr. 23, Prishtinë**, siç është e **cekur edhe në FDT** dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës duhet të dorëzohet, me të njëjtën mënyrë, tek Autoriteti Kontraktues.

30.2 Ankesa duhet të dorëzohet vetëm brenda periudhës 10 (dhjetë) ditësh, pas datës së Njoftimit të dhënies së kontratës apo rezultatit të konkursit të projektimit.

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

SEKSIONI II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD)

Të dhënat e mëposhtme për shërbime që do të prokurohen do të plotësojnë, shtojnë, ose ndryshojnë dispozitat e Informatave për Tenderuesin. Kurdo që paraqitet ndonjë mospërputhje, këto dispozita do të mbizotërojnë mbi ato në Informata për Tenderuesit.

[Udhëzimet për plotësimin e Fletës mbi të Dhënat e Tenderit janë shënuar me germa kursive për Nenet relevante të Informatave për Tenderuesit. Fshijini ato që nuk janë të nevojshme]

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante të Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit.	
Fusha e tenderit	1.1	<p>Autoriteti Kontraktues (AK) është:</p> <p>Emri i AK: <i>Agjencia Kosovare e Privatizimit</i></p> <p>Adresa e AK: Agim Ramadani nr 23</p> <p>Qyteti: <i>Prishtinë</i></p> <p>Kodi Postar: <i>10000</i></p> <p>Adresa Elektronike: <i>www.pak-ks.org</i></p> <p>Personi Kontaktues: <i>Bajram Sherifi dhe Albert Matoshi</i></p> <p>E-mail: <i>bsherifi@curtis.com dhe albert.matoshi@ks.gt.com</i></p> <p>Telefoni: <i>+381 (0) 38 500 400 ext 2101</i></p>
	1.2	<p>Titulli i kontratës: <i>Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP</i></p> <p>dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është:</p> <p>AKP-AL 001</p>
	1.3	<p>Data e shpalljes së Njoftimit për Kontratë: 21.12.2020</p> <p>Versionin e plotë të Njoftimit për Kontratë mund ta gjeni në web faqen e AKP-së në: <u>www.akp-ks.org</u></p> <p>II LËNDA E KONTRATËS:</p> <p>Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP</p> <p>Versioni i plotë i Njoftimit për Kontratë është në dispozicion në: <u>www.akp-ks.org</u></p> <p><i>Ndërsa publikimet do të behen në këto media: RTK1 dhe RTK 2 data e publikimit: 21.12.2020</i></p>
	1.4	Tenderi duhet të dorëzohet në adresën e përmendur në 1.1

<p>Qëllimi i Kontratës</p>	<p>2.1</p>	<p>Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP Ndarja e parcelave si pasojë e situatës së krijuar në terren pas ndërtimeve të infrastrukturës, krijimit të varrezave, ndërtimit të përmendoreve dhe lapidareve të luftës, etj. Nëpër shumë parcela të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat administrohen nga AKP-ja janë asfaltuar rrugë (nga komunat ose Ministria përkatëse) dhe asnjëherë nuk është realizuar shpronësimi (regjistrimi në regjistrat kadastral), kështu që me qëllim të privatizimit/likuidimit të tyre, parcelimi i pjesëve të tilla është i domosdoshëm. Gjithashtu, në shumë parcela të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore janë krijuar varreza (zakonisht të dëshmorëve të luftës) si dhe janë ndërtuar përmendore dhe lapidar, prandaj parcelimi është i domosdoshëm në mënyrë që të realizohet privatizimi/likuidimi i tyre. Raste të ngjashme janë edhe kur institucionet e nivelit lokal apo edhe qendror në parcelat e administruara nga AKP-ja kanë ndërtuar objekte për qëllime të ndryshme (çerdhe, shkolla, objekte të kulturës, etj.) prandaj parcelimi i tyre është i domosdoshëm për qëllime të lartcekura. Rast tjetër janë ndërtimet ilegale nga persona fizik apo juridik. Në rastet kur ato konsiderohen si ndërtime me karakter specifik nga AKP, atëherë matja/ndarja apo bashkimi i parcelave do të kërkohet të realizohet. Përveç kësaj do të trajtohen edhe anomalitë e tjera kadastrale. Rast tipik është mospërputhja e sipërfaqes grafike me atë tekstuale. AKP synon që brenda një afati të shkurtër kohor t’i zgjedh problemet e grumbulluara kadastrale si pasojë e mosazhurnimit të tyre me kohë, dhe si pasojë e marrjes së shënimeve kadastrale origjinale nga shteti i Serbisë.</p>
<p>Specifikacionet teknike të detyrueshme</p>	<p>3.1</p>	<p>Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentet dëshmuese për qëllimin e ofruar të kontratës, duke përfshirë: a. Deklaratën për specifikacionet teknike për shërbimet e ofruara të cilat përputhen me ato të përmendura në Aneksin 1 të dosjes së tenderit;</p>
<p>Kushtet dhe kërkesat e dërgesës</p>	<p>4.1</p>	<p>N/A</p>
<p>Afati kohor për kryerjen e shërbimeve</p>	<p>4.2</p>	<p>Afatet kohore për fillimin dhe/ose përfundimin e kontratës: 120 dite nga data e nënshkrimit të kontratës.</p>
<p>Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik</p>	<p>5.1</p>	<p>1.Deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. të vendit të themelimit të tenderuesit. 2.Vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së</p>

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

		<i>publikimit të Njoftimit të Kontratës] (vetëm per ofertën fituese.)</i>
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	6.1	<p>1. Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në shtetin e themelimit të operatorit ekonomik- Kopja e certifikatës së biznesit.</p> <p>2. Certifikata e Regjistrimit të biznesit – (te deshmohet me kopje)</p> <p>3. Licenca për punë kadastrale – (te deshmohet me kopje e licences)</p> <p>4. Kompania duhet te jete e licencuar nga Agjencioni Kadastral i Kosoves (AKK) (kërkohet kopja si dëshmi).</p>
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	7.1	<p><i>Operatori Ekonomik do të shpërblehet vetëm për një rajon. Përfundim mund të ketë nëse e dëshmon që ka kapacitete të mjaftueshme (kërkohet dëshmia):</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Janë gjithsej pesë (5) rajone: Rajoni i Mitrovicës, Rajoni i Prishtinës, Rajoni i Pejës, Rajoni i Prizrenit dhe Rajoni i Gjilanit.</i> <p><i>Shpejtësia e realizimit të shërbimeve (aktiviteteve kadastrale). Operatori Ekonomik duhet ta cek afatin e realizimit të shërbimeve.</i></p> <p>1. Referenca për punë të realizuara në tërë territorin e Kosovës (kërkohet dëshmia).</p> <p>2. Duhet te kete të paktën 1 (një) gjeodet të licencuar dhe 4 (katër) gjeodet me kualifikim minimal BSC të Gjeodezisë me nga 3 vite përvojë pune (kërkohet dëshmia).</p> <p>3. Të dëshmoj se disponon pajisje gjeodezike të mjaftueshme për realizimin e punëve (kërkohet dëshmia).</p> <p>4. Ofertimi i 2 (dy) apo më shumë OE për një rajon ose dy rajone do të ketë përparësi.</p> <p>5. Dëshmia për staf të mjaftueshëm (te deshmohet me listen e stafit te punetoreve)</p> <p>6. Dëshmia për pajisje gjeodezike të mjaftueshme (te deshmohet me listen e pajisjeve)</p>
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	8.1	<p>a. një deklaratë e qartë ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës</p> <p>b. një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit;</p> <p>c. një deklaratë të nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të</p>

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

		grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.
Nënkontraktimet	12.1	a) një deklaratë ku deklarohen nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatës të prokurimit, dhe b) Të gjithë nën kontraktorët do të jenë të përshtatshëm dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.
Siguria e tenderit	13.1	Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit. Vlera e sigurisë së tenderit: 1,000€ (një mijë euro) Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë: 90 dite nga data e dorëzimit të tenderit.
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shuma e sigurisë së ekzekutimit është 10% e shumës së kontratës me afat prej 5 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.
Periudha vlefshmërisë së tenderit	15.1	Periudha e vlefshmërisë së tenderit do të jetë: 60 ditë
Vulosja dhe Shënimi i Tenderëve	16.1	Përveç Tenderit origjinal, numri i kopjeve është 2 (dy)
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	17.1	Afati i fundit për dorëzim është 05/01/2021, ora 14:00 Zyrja e Autoritetit të Likuidimit, Selia e AKP-se, rr.Agim Ramadani, nr 23, Prishtine
Hapja e Tenderit	18.1	Hapja e tenderit do të bëhet me: 05/01/2021, ora 14:30
Kriteret e Dhënies	19.1	Tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm. Kriteret në %: 1) Propozimi teknik 70% <i>Nën kriteret e propozimit teknik:</i> <i>Metodologjia për realizimin e projektit 30%,</i> <i>Prototipi i Web GIS Aplikacionit për AKP 70%</i> 2) Propozimi financiar 30%
Ankesat	20.1	Çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë Komisionit Shqyrtues të Ankesave, AKP Prishtinë: Adresën e plotë: Rr. Agim Ramadani, Nr 23, Prishtinë

ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME

1. Qëllimi i Projektit

Ndarja e parcelave si pasojë e situatës së krijuar në terren pas ndërtimeve të infrastrukturës, krijimit të varrezave, ndërtimit të përmendoreve dhe lapidareve të luftës, etj.

Nëpër shumë parcela të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore të cilat administrohen nga AKP-ja janë asfaltuar rrugë (nga komunat ose Ministria përkatëse) dhe asnjëherë nuk është realizuar shpronësimi (regjistrimi në regjistrat kadastral), kështu që me qëllim të privatizimit/likuidimit të tyre, parcelimi i pjesëve të tilla është i domosdoshëm.

Gjithashtu, në shumë parcela të ish-Ndërmarrjeve Shoqërore janë krijuar varreza (zakonisht të dëshmorëve të luftës) si dhe janë ndërtuar përmendore dhe lapidar, prandaj parcelimi është i domosdoshëm në mënyrë që të realizohet privatizimi/likuidimi i tyre.

Raste të ngjashme janë edhe kur institucionet e nivelit lokal apo edhe qendror në parcelat e administruara nga AKP-ja kanë ndërtuar objekte për qëllime të ndryshme (çerdhe, shkolla, objekte të kulturës, etj.) prandaj parcelimi i tyre është i domosdoshëm për qëllime të lartcekura.

Rast tjetër janë ndërtimet ilegale nga persona fizik apo juridik. Në rastet kur ato konsiderohen si ndërtime me karakter specifik nga AKP, atëherë matja/ndarja apo bashkimi i parcelave do të kërkohet të realizohet.

Përveç kësaj do të trajtohen edhe anomalitë e tjera kadastrale. Rast tipik është mospërputhja e sipërfaqes grafike me atë tekstuale.

AKP synon që brenda një afati të shkurtër kohor t'i zgjedh problemet e grumbulluara kadastrale si pasojë e mosazhurnimit të tyre me kohë, dhe si pasojë e marrjes së shënimeve kadastrale origjinale nga shteti i Serbisë.

2. Dokumentacioni i nevojshëm për Operatorin Ekonomik

Operatorit Ekonomik/Gjeodetit të Licencuar do t'i dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm përshkrues për realizimin e ndarjeve të cilat do të jave paraprakisht të aprovuara nga AKP-ja.

OE do të autorizohet për nxjerrjen e Certifikatave mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme për parcelat në të cilat do të realizohet ndarja e tyre.

OE do të autorizohet për nxjerrjen e shënimeve kadastrale nga ZKK apo AKK-ja.

3. Detyra e projektit

Operatori Ekonomik duhet të realizoj ndarjen e parcelave kadastrale në terren, dhe pastaj duhet të siguroj shënimet kadastrale të azhurnuara. Të gjitha punët kadastrale duhet të realizohen duke u bazuar në Ligjin për Kadastër si dhe Udhëzimet Administrative (UA) të cilat janë në fuqi.

Mund të kërkohet edhe bashkimi i parcelave, apo harmonizimi i sipërfaqeve të tyre.

Rastet specifike, si aktivitetet kadastrale, mund të kërkohen gjithashtu. Rast tipik mund të jetë analiza e dokumenteve të azhurnuara nga ZKK-të përkatëse.

4. Specifikat teknike të të dhënave kadastrale

Sqarim i rëndësishëm:

Operatori Ekonomik (OE) duhet të siguroj koordinatat e pikave të kufijve të parcelave (nëse ekzistojnë në formën numerike) nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunave përkatëse.

OE duhet të siguroj Certifikatat mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme për parcelat e ndërmarrjeve shoqërore në të cilat do të ketë ndarje të parcelave (apo aktivitetet e tjera kadastrale).

Ndarja e parcelave (apo aktiviteve të tjera kadastrale) duhet të realizohet pas aprovimit nga AKP-ja.

5. Rrjeta Gjeodezike

Operatori Ekonomik do të vendos rrjetën gjeodezike sipas kërkesës në terren. Rrjeta gjeodezike duhet të vendoset dhe të barazohet sipas kornizave për punë praktike të nxjerra nga AKK, apo të përdor sistemin KOPOS.

6. Matjet Kadastrale

Matjet kadastrale (mund të ketë edhe ri-rregullim të kufijve) si dhe shënimi i kufijve në terren duhet të realizohet me shenja të përhershme/përkohshme bazuar në Ligjin për Kadastër dhe rregulloret përkatëse në fuqi.

7. Dokumentacioni dhe të dhënat që duhet të dorëzohen nga Operatori Ekonomik

Të dhënat grafike duhet të dorëzohen në:

- Formë analoge - letër (A4/A3/A2/A1/A0 format).
- Formë digjitale në “*.dwg, *.dxf, *.shp”.

Të dhënat tekstuale që duhet të dorëzohen:

- Certifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, pas realizimit të matjeve/ndarjeve (apo aktiviteteve tjera kadastrale) në terren.
- Kopja e planit pas realizimit të matjeve/ndarjeve në terren.
- Elaborati i matjeve të realizuara.

8. Matjet origjinale

Koordinatat (të aprovuara nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës përkatëse) e parcelave në të cilat do të ketë aktivitete kadastrale duhet të sigurohen zyrtarisht nga ZKK përkatëse.

AKP do ta autorizoj OE (apo Gjeodetin e licencuar) për sigurimin e të dhënave kadastrale për pronat në të cilat do të realizohet ndarja (në raste të rralla mund të ketë bashkim të parcelave).

Matjet origjinale nga terreni, të dhënat e matura nga terreni, duhet të dorëzohen sipas kriterëve të përcaktuara me Udhëzime Administrative që rezultojnë nga Ligji për Kadastër dhe UA përkatëse.

9. Kontrolli i Kualitetit

Të dhënat e dorëzuara nga Operatori Ekonomik duhet t’i nënshtrohen kontrollit të kualitetit konform Ligjit për Kadastër, kornizave për punë praktike si dhe doracakut për kontrollë të kualitetit.

10. Kushtet që duhet të plotësohen nga Ofertuesit

- Regjistrimin si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës.
- Regjistrimin për numër fiskal në Administratën Tatimore të Kosovës.
- Operatori Ekonomik duhet të jetë i licencuar për punë kadastrale nga AKK-ja.
- Operatori Ekonomik duhet të ketë përmbushur të gjitha obligimet ndaj ATK-së.

Dokumentacioni i kërkuar:

- Certifikata e Regjistrimit të biznesit - kopje (obligative).
- Licenca për punë kadastrale - kopje (obligative).
- Vërtetimi nga ATK-ja - original (obligative).
- Dëshmia për staf të mjaftueshëm.
- Dëshmia për pajisje gjeodezike të mjaftueshme.

11. Përshkrimi i Çmimeve

Parcelat në të cilat kërkohet ndarja e tyre ndodhen në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Zakonisht ndarja kërkohet për parcelat, kultura e të cilave nuk është mal.

Nuk është i përcaktuar numri i parcelave për të cilat do të kërkohet ndarja e parcelave. Sipas parallogaritjeve të AKP-së, numri i parcelave ku kërkohen aktivitetete të tilla është afërsisht 150.

Realizimi i ndarjeve duhet të jetë në përputhje me çmimoren për realizimin e punëve kadastrale të aprovuar nga Ministria përkatëse, gjegjësisht Agjencia Kadastrale e Kosovës. Ndërsa për punët shtesë të cilat vijnë si pasojë e mospërgjigjes nga ana e zyreve komunale, OE mund të ofertoj çmim për angazhimin e tyre ditor.

Në raste të veçanta mund të kërkohet edhe matja e objekteve ekzistuese. Për objektet ekzistuese OE duhet të ofertoj me çmim të ndarë.

OE obligohet të mbajë konfidencën për punët e realizuara duke pasur parasysh natyrën e punës së AKP.

12. Kriteret për dhënie të kontratës

1. Normalisht një Operator Ekonomik do të shpërblehet vetëm për një rajon. Përjashtim mund të ketë nëse e dëshmon që ka kapacitete të mjaftueshme (kërkohet dëshmia):
 - Janë gjithsej pesë (5) rajone: Rajoni i Mitrovicës, Rajoni i Prishtinës, Rajoni i Pejës, Rajoni i Prizrenit dhe Rajoni i Gjilanit.
2. Vendndodhja (selia) e Operatorit Ekonomik (do të merret parasysh zvogëlimi i shpenzimeve, prandaj vetëm në rast të mos-ofertimit të operatorëve ekonomik nga rajoni i caktuar mund të zgjedhet ndonjë operator tjetër ekonomik nga rajoni tjetër).
3. Shpejtësia e realizimit të shërbimeve (aktiviteteve kadastrale). Operatori Ekonomik duhet ta cek edhe afatin e realizimit të shërbimeve.
4. Referenca për punë të realizuara në tërë territorin e Kosovës (kërkohet dëshmia).
5. Kompania e licencuar nga AKK (kërkohet dëshmia).
6. Të paktën 1 (një) gjeodet të licencuar dhe 4 (katër) gjeodet me kualifikim minimal BSC të Gjeodezisë me nga 3 vite përvojë pune (kërkohet dëshmia).
7. Të dëshmoj se disponon pajisje gjeodezike të mjaftueshme për realizimin e punëve (kërkohet dëshmia).
8. Joint venture apo ofertimi i 2 (dy) apo më shumë OE për një rajon ose dy rajon do të ketë përparësi.

Operatori Ekonomik do të shpërblehet vetëm për një rajon. Përjashtim mund të ketë nëse e dëshmon që ka kapacitete të mjaftueshme (kërkohet dëshmia):

• Janë gjithsej pesë (5) rajone: Rajoni i Mitrovicës, Rajoni i Prishtinës, Rajoni i Pejës, Rajoni i Prizrenit dhe Rajoni i Gjilanit.

Shpejtësia e realizimit të shërbimeve (aktiviteteve kadastrale). Operatori Ekonomik duhet ta cek afatin e realizimit të shërbimeve.

1. Referenca për punë të realizuara në tërë territorin e Kosovës (kërkohet dëshmia).
2. Duhet te kete të paktën 1 (një) gjeodet të licencuar dhe 4 (katër) gjeodet me kualifikim minimal BSC të Gjeodezisë me nga 3 vite përvojë pune (kërkohet dëshmia).
3. Të dëshmoj se disponon pajisje gjeodezike të mjaftueshme për realizimin e punëve (kërkohet dëshmia).

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

- 4.Ofertimi i 2 (dy) apo më shumë OE për një rajon ose dy rajone do të ketë përparësi.
5. Dëshmia për staf të mjaftueshëm (te deshmohet me listen e stafit te punetoreve)
- 6..Dëshmia për pajisje gjeodezike të mjaftueshme (te deshmohet me listen e pajisjeve)

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Ndarja / Bashkimi i parcelave	1
2	Matja e parcelave preleminare	1
3	Matja e parcelave përfundimtare	1
4	Matja e objekteve (pa regjistrim)	m ²
5	Matja e objekteve (me regjistrim)	m ²

ANEKSI 2 DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: [operatorin ekonomik që paraqitet] deklaroj nën betim se jam i përshtatshëm në përputhje me Nenin 65, të Ligjit mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 03/L-241.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në Nenin 65 të LPP-së, respektivisht paragrafin 6 të Informacionit për Tenderuesit dhe siguroj se jam i përshtatshëm të marrë pjesë.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

ANEKSI 4 SIGURIA E TENDERIT

Për: Agjencia Kosovare e Privatizimit

(në vazhdim: “autoriteti kontraktues”)

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]

(në vazhdim “tenderuesi”)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001

Garancion me kërkesë te pare

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t`i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: _____ zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a. Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;
- b. Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;
- c. Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
 - Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
 - Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
 - Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuar në dosjen e tenderit.

Pagesa në shumën e limituar prej: _____ siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlen deri me:

Nënshkrimi dhe vula e garantuesit

Emri i institucionit financiar

Adresa

Data

ANEKSI 5 KËRKESA PËR INFORMACIONE SHITESË

Për: <emri dhe adresa e autoritetit kontraktues>

DUKE MARRË PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej “Operatori Ekonomik”), pas pranimit të dosjes së tenderit nën Nr. e Prokurimit të sipër-përmendur, beson se nevojiten informacionet shtesë ose informacionet sqaruese si në vijim:

Identifikimi i informacioneve shtesë ose i informacioneve sqaruese, përfshirë referimet në pjesën apo në pjesët e dosjes së tenderit:

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj kërkoj marrjen e informacioneve të identikuara.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

¹³ Nëse disa karakteristika merren në konsiderate, përshkruaj peshën dhe përcakto metodën e vlerësimit për secilën

¹⁴ ku Q- Pikët për tenderin, Qs= Pikët për karakteristikat më të mira, Qt = pikët për karakteristikat e tenderit

PJESA B: DRAFT KONTRATA² & KUSHTET SPECIALE & ANEKSET E NDËRLIDHURA

PJESA I E KONTRATËS: DRAFT KONTRATA

Agjencia Kosovare e Privatizimit
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe

[*Emri Ofruesit te Shërbimeve*], (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shërbimet e shënuara me poshtë:

[*shëno Titullin*] me numër identifikues: AKP-AL 001

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është performimi i shërbimeve në vijim nga ana e Ofruesit të Shërbimeve:

Qëllimi i kontratës është performimi i shërbimeve në vijim:

○

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i shërbimeve duhet të jetë: [*shëno çmimin e shërbimeve në shifra*] €; [*shëno çmimin e shërbimeve me fjalë*] Euro.

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Përshkrimi i Çmimeve);
- (f) [*shëno çdo dispozitë tjetër të dosjes së tenderit*].

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

² Para nënshkrimit të Kontratës "kjo Draft Kontrate" duhet të modifikohet nga Autoriteti Kontraktues sipas kushteve të aktivitetit përkatës të prokurimit

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

Neni 4 Komunikimet

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Ofruesin e Shërbimeve.

Për Ofruesin e Shërbimeve

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:		Emri:	Bajram Sherifi dhe Albert Matoshi
Pozita:		Pozita:	Kryesues te Autoritetit te Likuidimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	
Vula:		Vula:	

PJESA II E KONTRATES

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 **“Kontratë”** do të thotë marrëveshje të lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkuorporuar me referencë në të.

1.2 **“Shërbimet”** do të thotë shërbimet që do të ekzekutohen nga ana e Ofruesit të Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit të përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 **“Ofrues i shërbimeve”** është Operatori Ekonomik ose grupi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 **“Personeli”** do të thotë personat e angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 **“Çmimi i kontratës”** do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 **“Nënkontraktuesi”** do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 **“Palë”** nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe “Palët” nënkupton të dy prej tyre.

1.8 **“Autoriteti Kontraktues”** nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 **“KPK”** nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 **“KVK”** nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Ligji i aplikueshëm dhe gjuha

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhet ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguroesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguroesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk nënkontraktton pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

Autoritetit kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofruesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofruesit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

4.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve, ka marrë ndonjë obligim të vazhdueshëm që vazhdon për një periudhë që e tejkalon atë të periudhës së garancisë nën kontratë ndaj Ofruesit të Shërbimeve, përkitazi me furnizimet që i jep nënkontraktuesi, Ofruesi i Shërbimeve duhet që, në çfarëdo momenti pas skadimit të periudhës së garancisë, t'i transferojë menjëherë te Autoriteti kontraktues, me kërkesë dhe shpenzime të Autoritetit kontraktues, përfitimet e obligimeve të tilla për kohëzgjatjen e garancisë së skaduar.

Neni 5 Tatimet dhe Doganat

5.1 Ofruesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofruesi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve

6.1 Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të kontratës nga të dy palët ose në një datë tjetër të mëvonshme siç mund të ceket në KVK.

6.2 Para fillimit të Shërbimeve, Ofruesi i Shërbimeve do të dorëzojë Autoritetit Kontraktues për miratim një Program që tregon metodat, aranzhimet, rendin dhe kohën për të gjitha aktivitetet. Shërbimet do të kryhen në pajtim me programin e miratuar.

6.3 Ofruesi i Shërbimeve do të fillojë shërbimet sa më shpejt që është arsyeshëm e mundur pas marrjes së urdhrimit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.4 Ofruesi i Shërbimeve do të përfundojë aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, siç është e specifikuar në KVK. Nëse Ofruesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e planifikuar të përfundimit, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit të të gjitha aktiviteteve.

6.5 Vendi i kryerjes së shërbimeve është i përcaktuar në KVK.

6.6 Përveç nëse palët pajtohen që të bëhet ndryshe, ekzekutimi i kontratës do të fillojë jo më vonë se 90 ditë pas njoftimit të dhënies së kontratës. Pas kësaj date Ofruesi i Shërbimeve do të ketë të drejtë të mos e ekzekutojë kontratën dhe ta marrë ndërprerjen e saj ose kompensimin për dëmin që i është shkaktuar. Ofruesit të Shërbimeve do t'i merret kjo e drejtë, përveç nëse e ushtron brenda 30 ditësh pas skadimit të periudhës 90-ditore.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së përfundimit

7.1 Ofruesi i Shërbimeve mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsye:

- a) Autoriteti kontraktues ka dështuar t'i plotësojë obligimet e veta sipas kontratës;
- b) forca madhore siç është e definuar në Nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do të njoftojë Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që të bëjë një kërkesë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përveçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive të përmendura në 11.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose të informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

Neni 8 Forca madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do të thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çrregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, bllokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimat, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplozimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjeluar paaftësinë e një pale të tillë që të përmbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dështimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, menjëherë do ta lajmërojë palën tjetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjaft praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjete të tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

(a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përmbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitohet ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë të shërbimeve;

(b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhrave administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;

(c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;

(d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;

(e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;

(f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja nga ana e Ofruesit të Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumën që duhet të paguhet në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes së tillë, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofruesi i Shërbimeve do të kryej Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikën më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të veprojë sipas urdhrave administrative që i jep autoriteti kontraktues. Nëse Ofruesi i Shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtej fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo është e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, ai nuk do të publikojë ose shpallë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

11.5 Nëse Ofruesi i Shërbimeve është konsorcium i dy ose më tepër personave, të gjithë personat e tillë do të jenë bashkërisht dhe vazhdimisht të obliguar t'i plotësojnë kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi që të veprojë në emër të tij për qëllime të kësaj kontrate do të ketë autoritetin që të lidh konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues.

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësoj personelin kyç të identifikuar në tender e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë ekzekutimit, dhe në bazë të kërkesës me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë për një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryen detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të propozuar të personelit kryesor, vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë janë thelbsisht të barabarta ose më të mirë se ato të identikuara.

Neni 12 Obligimet e Autoriteti Kontraktues

12.1 Autoriteti kontraktues do t'i ofrojë ofruesit të shërbimeve menjëherë ndonjë informacion dhe/ose dokumentacion në dispozicion të tij, që mund të jenë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla do t'i kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunoj sa më shumë që është e mundur me Ofruesin e Shërbimeve për t'i siguruar informacione që ky i fundit mund t'i kërkoj në mënyrë të arsyeshme për kryerjen e kontratës.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "*Menaxherin e Projektit*", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 Dëmet e likuiduara

13.1 Ofruesi i Shërbimeve do të paguaj dëmet e likuiduara Autoritetit Kontraktues në normën ditore të cekur në KVK për çdo ditë që Data e Përfundimit është me vonë se Data e Kërkuar e Përfundimit. Shuma totale e dëmeve të likuiduara nuk duhet të tejkaloj shumën e përcaktuar në KVK. Autoriteti Kontraktues mund të zbrës dëmet e likuiduara nga pagesat për shkak të Ofruesit të Shërbimeve. Pagesa e dëmeve të likuiduara nuk do të ndikoj në detyrimet e Ofruesit të Shërbimeve.

13.2 Nëse Data e përfundimit është zgjatur pasi që janë paguar dëmet e likuiduara, Autoriteti kontraktues do të përmirësojë çdo pagesë të tepërt të dëmeve të likuiduara nga ofruesi i shërbimit, duke rregulluar certifikatën e ardhshme të pagesës.

Neni 14 Siguria e ekzekutimit

14.1 Ofruesi i Shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues për çfarëdo humbjeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Siguria do të vazhdoj të jetë valide 30 ditë pas lëshimit të Certifikatës së Përfundimit.

14.3 Siguria e ekzekutimit të kontratës do të jetë në formën e dhënë në pjesën IV të kontratës.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimeve

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe për mbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet e përgjithshme të pagesës

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Metoda dhe kushtet e pagesës që duhet t'i behet Ofruesit të Shërbimeve sipas kësaj Kontrate do të specifikohen në KVK.

16.2 Pagesat që duhet të bëhen sipas faturës së lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjesën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.3 Shumat duhet të paguhën brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.4 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar Ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmbajtësore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund të mos jetë legjitim. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.5 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.3, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.6 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.3 do t'i japin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

Neni 17 Kontrolli i kualitetit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitë e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është si në KVK.

Neni 18 Korrigjimi i defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektet të korrigjohet.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues.

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrigjuar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësojë koston e korrigjimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuencat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur në Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) Dëme të përgjithshme; ose
- b) Dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjeke për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

PJESA III E KONTRATES KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Kosovë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqip
Fillimi dhe Përfundimi i shërbimeve	6.1	Data e Fillimit të fillimit të Shërbimeve :
	6.4	Data e Përfundimit është :
	6.5	Vendi i kryerjes së shërbimeve është
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Menaxheri i Projektit
Siguria e ekzekutimit	14.1	Shume e Sigurisë së Ekzekutimit është <i>[shëno shumën e sigurisë së ekzekutimit]</i>
Parimet e përgjithshme të pagesës	16.1	Orari i pagesës do të jetë: Brenda 30 ditësh nga dorëzimi dhe verifikimi i faturave të shërbimeve
Kontrrolli i kualitetit	17.1	Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në vijim: <i>[shëno]</i> Periodha Garantuese e Defekteve është <i>7 muaj</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>në Gjykatën Themelore në pajtim me ligjin në Kosovë.</i>

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT
[Me logon e institucionit financiar që e jep sigurinë]

Për: Agjencia Kosovare e Privatizimit
(në vazhdim: “autoriteti kontraktues”)

Në emër të: [emri dhe adresa e operatorit ekonomik]
(në vazhdim “operatori ekonomik”)

Titulli i aktivitetit të prokurimit:

Numri i Prokurimit:

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: < *shuma e sigurisë me fjalë dhe shifra* > zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: <shuma e garantuar> siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin “e pranimit”.

Kjo siguri vlen deri me: <data dhe koha >

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i institucionit financiar

Adresa

Data

PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Kontakti	
Telefoni	
Faks	
E-mail	
Numri i TVSH	

BANKA	
Emri	
Adresa	
Qyteti	
Kodi Postar	
Shteti	
Llogaria Bankare	
IBAN (opcionale)	
BIC (Opcionale)	

SHËNIME:

<u>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAQËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)</u>

<u>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)</u>

PJESA C: FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

PJESA I. FORMULARI I TENDERIT

Për: Agjencia Kosovare e Privatizimit
(në vazhdim të tekstit “Autoriteti Kontraktues”)

Titulli i kontratës: Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. I kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit me Numër të Prokurimit: AKP - AL 001. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

Agjencia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit: [shëno çmimin e tenderit në shifra €]
Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

3. Çmimi total i tenderit është: _____
4. Ky tender është valid për një periudhë prej [60 ditëve] nga data finale për dorëzim të tenderëve.
5. [Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës 10% e vlerës së kontratës
6. Operatori Ekonomik [dhe nënkontraktuesit tonë] kanë këtë nacionalitet: [shëno nacionalitetin]
7. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender _____ me të drejtën tonë të udhëhequr nga ne. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër.
8. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të financuara nga BKK.
9. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e rezervon të drejtën për të dhënë vetëm një pjesë të kontratës. Ai nuk do të shkaktojë detyrime ndaj nesh nëse e bën këtë.

E DORËZUAR NGA

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	
ADRESA E PLOTE	
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI	
POZITA	
NËNSHKRIMI	
DATA	

Numri i Prokurimit: AKP-AL 001 –Titulli **Matjet për parcelat kadastrale që administrohen nga AKP**

VULA	
-------------	--

[Në rast Grupi Operatorësh ekonomik:]

	Emri (emrat)	Vend-selia
Partneri 1*		
Etj ... *		

** shtoni/fshini rreshta plotësues për partnerët sipas nevojës. Vini re që nënkontraktuesi nuk konsiderohet si partner për qëllime të kësaj procedure të tenderit.*

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar për të nënshkruar këtë tender në emër të Konsorciumit: [shëno emrin dhe mbiemrin]

Nënshkrimi: [nënshkrimi i personit të autorizuar]

Vendi dhe data: [shëno vendin dhe datën]

Vula e Udhëheqësit: _____

Pjesa II. Përshkrimi i Çmimeve

Nr.	Përshkrimi	Sasia	Çmimi për njësi	Çmimi i përgjithshëm
1	Ndarja / Bashkimi i parcelave	1	UA 12/19	
2	Matja e parcelave preleminare	1		
3	Matja e parcelave përfundimtare	1	UA 12/19	
4	Matja e objekteve (pa regjistrim)	m ²		
5	Matja e objekteve (me regjistrim)	m ²	UA 12/19	
TOTAL (përfshirë të gjitha taksat e aplikueshme në Kosovë)				

IDENTIFIKIM I OPERATORIT EKONOMIK (OE)	
EMRI I OE:	
EMRI DHE MBIEMRI I PËRFAQËSUESIT TE OE:	
NËNSHKRIMI:	
NUMRI I TELEFONIT:	
E-MAILI	
DATA:	
VULA:	